


**Rruga "Dora D'istria", Nr.10,
P.O. Box 8363, Tiranë,
+355 4 22 28 260**

www.amf.gov.al



Sigurimi i Përgjegjësive të Përgjithshme Civile



AMF 043254-893
AMF 043254-8732-
218292-57843294212
42714-3673245254-3
9-4-05
45-34
A-5784-85
A-36732-34
A-57844-85
A-36732-34
21-12
42732-88
36732-05
AMF 02-578492-895
3351369333-31731

amf

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Përmbajtja

1. SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME CIVILE
2. SI TË MERRNI NJË POLICË TË PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME CIVILE
3. ÇFARË DUHET TË DINI PËR DISA NGA POLICAT E PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME CIVILE
 - 3.1 Sigurimi i Përgjegjësive Publike
 - 3.2 Sigurimi i Përgjegjësive së Produktit
 - 3.3 Sigurimi i Përgjegjësive Profesionale
 - Sigurimi i përgjegjësive profesionale të brokerit
 - Sigurimi i përgjegjësive profesionale të vlerësuesit të dëmeve
 - Sigurimi i përgjegjësive profesionale të agjentit në sigurime
 - Sigurimi i përgjegjësive së noterit
 - Sigurimi i detyrueshëm për përgjegjësinë e organizatorit të paketës së udhëtimit
 - Sigurimi i detyrueshëm i objekteve në bashkëpronësi
 - Sigurimi i detyrueshëm i objekteve, përgjegjësive civile dhe profesionale në ndërtim për një periudhë 10 vjeçare
 - Sigurimi i detyrueshëm për dëmet shkaktuar palëve të treta, në rast aksidenti prej sistemeve dhe bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës
 - Sigurimi i përgjegjësive ligjore për dëmet që mund të shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë të shoqërive të autorizuara për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre
4. KU MUND TË SIGUROHENI
5. DETYRIMET PËR INFORMIM
6. ANKIMIMI
7. LEGJISLACIONI

1. SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME CIVILE

Ky material informues ka për qëllim t'i shërbejë konsumatorit si një udhëzues, për t'i ndihmuar të kenë më tepër informacion përpara se të vendosin për të marrë një kontratë sigurimi. Materiali jep informacion edhe mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit.

Sigurimi i Përgjegjësive përfshin një grup kontratash sigurimi të përgjegjësive, të cilat mbulojnë përgjegjësinë ligjore të të siguruarit, ndaj dëmeve që u shkaktohen palëve të treta nga ngjarja e sigurimit e ndodhur si pasojë e gabimeve, neglizhencës apo mangësive profesionale, gjatë ushtrimit të profesionit. Në këto sigurime përfshihen profesione si: Noteri, Arkitekti/inxhinieri, etj.



Ligjet të veçanta të fushave, përcaktojnë edhe mundësinë për t'u siguruar nga ngjarje të mundshme me pasoja dëmtime ndaj palëve të treta siç mund të jenë puna në profesionet e brokerimit, agjentit, vlerësuesit të dëmeve në tregun e sigurime, etj.

Subjektet e përfshira në një kontratë të Përgjegjësisë së Përgjithshme Civile janë persona fizikë ose juridikë që marrin një policë sigurime dhe paguajnë një prim pranë një shoqërie sigurimi.

I siguruari është personi të cilit i intereson të jetë i mbrojtur nga mundësia e një dëmi që mund të shkaktohet mbi të vetë ose mbi pasurinë e tij.

Polica e sigurimit mbulon dëmet e shkaktuara drejtpërdrejt nga i siguruari, p.sh. nga veprimtaria e një brokeri, agjenti në sigurime apo vlerësuesi dëmsh gjatë zhvillimit të aktivitetit profesional.



Një tjetër sigurim janë edhe sigurimet në raste aksidentesh prej sistemeve të bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm, apo për shkak të ushtrimit të veprimtarisë të shoqërive të autorizuara për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre.

2. SI TË MERRNI NJË POLICË TË PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME CIVILE

Në përgjithësi, në kontratat e përgjegjësive të përgjithshme civile përdoret lloji i policës së sigurimit të quajtur loss occurrence “Humbja e ndodhur”.

Kjo policë ju mbulon për çdo ngjarje që mund t’ju ndodhë ju brenda një afati të përcaktuar kohor të përcaktuar në kontratë, pavarësisht faktit se kur ju e kërkonti këtë dëm.




Kjo tip police sigurimi është e detyruar t’i përgjigjet dëmit që ju është shkaktuar dhe që shfaqet edhe pasi ka përfunduar afati i policës, me kushtin që incidenti apo ngjarja të ketë ndodhur gjatë periudhës së mbulimit.

3. DISA NGA POLICAT E PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME CIVILE

Sigurimi i përgjegjësive ndahet në tre grupe të mëdha:

- Sigurimi i përgjegjësive publike
- Sigurimi i përgjegjësive profesionale
- Sigurimi i përgjegjësive të produktit



Sigurimi i përgjegjësive publike mbulon të siguruarin sipas një kontrate sigurimi për dëmtime të shkaktuara në mënyrë të paqëllimshme, si dëme trupore, pasurore ndaj personave të tretë përmes veprimtarisë prodhuese, ndërtuese dhe përdoruese në mjediset e biznesit. Primit e sigurimit për këto lloje sigurimesh kushtëzohen nga veprimtaria, procesi i punës, dhe kushte të tjera.

Sigurimi i përgjegjësive profesionale mbulon të siguruarin sipas një kontrate sigurimi për dëmtime që u shkaktohen palëve të treta gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale të të siguarit, si pasojë e neglizhencës, mosveprimit, gabimit, apo harresës në ushtrimin e profesionit. Këto produkte sigurimi drejtohen veçanërisht për profesione si: arkitektët, inxhinierët, vlerësuesit e pasurive të paluajtshme, agjentët e sigurimit, këshilltarët e investimeve, brokera, Avokatët, Noterët, etj.

Sigurimi i përgjegjësive të produktit ofron mbulimin me sigurim të biznesit për përgjegjësinë e produkteve që prodhohen apo nxirren në tregohen. Ky sigurim i përgjegjësive të produktit, çliron biznesmenët, shitësit, administratorët nga përgjegjësitë/dëmshpërblimit financiar për produktin e hedhur në treg.

Ky sigurim mbulon veprimtarinë e prodhuesve, duke dëmshpërblyer konsumatorët e këtij produkti, në rast se ata dëmtohen gjatë konsumimit të produktit.



DISA NGA SIGURIMET E PËRGJEGJËSISË SË PËRGJITHSHME PROFESIONALE

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale të brokerit

Brokeri në sigurime është personi fizik i licencuar nga AMF për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime. Veprimtaria e tij rregullohet në bazë të Ligjit 52/2014 datë 22.05.2014.



Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe garancia financiare e brokerit/ shoqërisë së brokerimit në sigurime

Shoqëria e brokerimit/ brokeri siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale të tij/të saj ndaj palëve të treta, në një shumë jo më të vogël se 30,000,000 lekë, për çdo dëm të shkaktuar si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, dhe jo më të vogël se 100,000,000 lekë, për të gjitha dëmet në një vit kalendarik.

Brokëri/shoqëria e brokerimit ushtron veprimtarinë e brokerimit duke mbrojtur interesat e të siguruarve. Për të përmbushur këtë detyrim, brokeri/shoqëria e brokerimit në sigurime kryen analizë rreziku të përshtatshme dhe përcakton parimet bazë të mbulimit të kërkuar. Brokëri/shoqëria e brokerimit kryen shërbime brokerimi në emër të të siguruarve për nënshkrimin e kontratave të sigurimit, të cilat janë në përputhje me kërkesat e të siguruarit për sa i përket mbulimit në sigurime. Këto shërbime brokerimi mund të kufizohen në shërbime të veçanta sigurimi nëse brokeri e ka informuar shprehimisht më parë të siguruarin për këtë gjë.



Sigurimi i përgjegjësisë profesionale të vlerësuesit të dëmeve

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime është personi fizik, i licencuar nga AMF, për të ushtruar veprimtarinë në sigurime. Veprimtaria e tij rregullohet në bazë të Ligjit 52/2014 datë 22.05.2014.

Vlerësuesi i dëmeve mban një policë sigurimi të përgjegjësisë profesionale ose një lloj garancie tjetër të ngjashme, për dëmet e ndodhura si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij, jo më pak se 30,000,000 lekë për çdo dëm dhe jo më pak se 100,000,000 lekë për të gjitha dëmet në një vit kalendarik.



Agjenti në sigurime është personi fizik, i licencuar nga AMF, për të ushtruar veprimtarinë në sigurime. Veprimtaria e tij rregullohet në bazë të Ligjit 52/2014 datë 22.05.2014.

Sigurimi i përgjegjesisë profesionale të agentit në sigurime

Sigurimi i përgjegjesisë profesionale dhe garancia financiare e agjentit/shoqërisë së agjentëve në sigurime

1. Agjenti/shoqëria e agjentëve në sigurime siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale të saj ndaj palëve të treta.
2. Autoriteti përcakton me rregullore shumën e mbulimit të policës së sigurimit të përgjegjesisë, (Sigurimi i përgjegjesisë profesionale ndaj palëve të treta, kundrejt dëmeve të shkaktuara nga kryerja e veprimtarisë së agjentit në një shumë jo më të vogël se 100,000 Lekë për çdo ngjarje të siguruar, ose jo më të vogël se 150,000 Lekë në vit për të gjitha rastet.



Sigurimi i përgjegjësisë së noterit

Noteri duhet të lidhë kontratë sigurimi për përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë noteriale. Ligji përcakton se kur noteri e zhvillon veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin, ai është përgjegjës ndaj palëve për dëmin e shkaktuar.



Sigurimi i përgjegjësisë së noterit, bazohet në nenin 25 të Ligjit nr. 9216, datë 1.4.2004 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “ Për noterinë”, ndryshuar me Ligjin nr. 8790, datë 10.5.2001”.

1. Noteri, përpara fillimit të ushtrimit të funksionit, lidh kontratë sigurimi të përgjegjësive profesionale me një kompani sigurimi vendase ose të huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë individuale ose bazuar mbi një kontratë kolektive të lidhur midis Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe kompanisë së sigurimit, për të gjitha dëmet që ai mund t'u shkaktojë klientëve apo palëve të treta gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.

2. Dhoma kontraktin, përzgjedh dhe lidh kontratën kolektive të sigurimit të noterëve, në të cilën janë palë Dhoma dhe kompania përkatëse e sigurimit. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, ky sigurim kolektiv mund të bëhet i detyrueshëm për të gjithë noterët.

3. Vlera përkatëse e sigurimit kolektiv paguhet nga secili noter në llogari të Dhomës, e cila më pas derdh detyrimin përkatës në kompaninë e sigurimit, sipas marrëveshjes së nënshkruar.

4. Kushtet dhe afatet e sigurimit kolektiv përcaktohen bashkërisht nga kompania e sigurimeve dhe Dhoma, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Polica e sigurimit individual ose kolektiv duhet të mbulojë edhe dëmet e shkaktuara nga të punësuarit e noterit, përfshirë këtu zëvendësnoterin.

6. Shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar, dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje, përcaktohen me urdhër nga ministri i Drejtësisë, pasi është marrë edhe mendimi me shkrim i Dhomës.



Sigurimi i detyrueshëm për përgjegjësinë e organizatorit të paketës së udhëtimit

Sigurimi i detyrueshëm për përgjegjësinë e organizatorit të paketës së udhëtimit për dëme të shkaktuara, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe të falimentimit bazohet në në nenin 55 të Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”.

Organizatori i paketës së udhëtimit duhet të ketë një kontratë sigurimi të detyrueshme, që mbulon përgjegjësinë e tij për dëmet e shkaktuara, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe falimentimit.



Kontrata e sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për sigurimin dhe risigurimin, dhe mbulon:

- Kthimin e parave të paguara nga konsumatori, sipas kontratës së paketës së udhëtimit;
- Kompensimin e diferencës, nëse gjatë paketës së udhëtimit përmbushen vetëm një pjesë e shërbimeve të kontraktuara;
 - Shpenzimet për kthimin e konsumatorit në vendin e nisjes.



Sigurimi i detyrueshëm i objekteve në bashkëpronësi



Sigurimi i objekteve në bashkëpronësi bazohet në Nenin 36 të Ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

Objektet që janë në bashkëpronësi në një ndërtesë banimi përcaktohen shprehimisht në aktin e pronësisë mbi banesën të secilit bashkëpronar, si p.sh. shkallët, tarraca, oxhaqet, parkimet, bodrumi, ashensori, instalimet e ujit, instalimet elektrike, instalimet e telefonisë, etj.

Zbatimi i rregullave mbi bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit kontrollohet nga **inspektorati vendor** (inspektorati ndërtimor dhe urbanistik i bashkisë/komunës).

Pas çdo kontrolli (si p.sh. për mbrojtjen kundër zjarrit, ruajtjen e higjienës apo kontrollin e ashensorëve), inspektori përkatës shprehet me një akt, të cilin e shpall në një vend të dukshëm në godinën e inspektuar dhe njëkohësisht ia njofton kryesisë dhe administratorit apo shoqërisë administruese përkatëse, për gjendjen e përgjithshme të ndërtesës, si dhe për masat që duhet të merren në rast se ka nevojë për të tilla.

Asambleja e Bashkëpronarëve merr vendim brenda afatit të përcaktuar në akt dhe autorizon administratorin/shoqërinë administruese për ndreqjen e të metave, duke siguruar financimin e nevojshëm nga bashkëpronarët.

Pronari i njësisë përgjigjet për sigurimin e pronës së vet, ndërsa asambleja e bashkëpronarëve përgjigjet për sigurimin e pronës së përbashkët.



Sigurimi i detyrueshëm i objekteve, përgjegjësisë civile dhe profesionale në ndërtim për një periudhë 10 vjeçare

Sigurimi i detyrueshëm i objekteve, përgjegjësisë civile dhe profesionale në ndërtim për një periudhë 10 vjeçare është i organizuar në bazë të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, datë 31.07.2014.

Në nenet e këtij ligji saktësohet se planifikimi dhe zhvillimi i territorit bazohet në parime siç janë ndër të tjera edhe sigurimi i detyrueshëm i objekteve, i përgjegjësisë civile dhe profesionale në ndërtim.



Neni 47

Dorëzimi i lejes së ndërtimit

Dorëzimi i lejes së ndërtimit paraprihet nga kryerja dhe dorëzimi i sigurimit të detyrueshëm për mbulimin e përgjegjësisë civile dhe profesionale që rrjedhin nga mosrespektimi i legjislacionit dhe dokumenteve të planifikimit në fuqi. Përgjegjësitë që janë objekt sigurimi të detyrueshëm në fushën e ndërtimit detajohen në rregulloren e zhvillimit.



Neni 42, pika 10

Njëkohësisht me lidhjen e kontratës për kalimin e pronësisë së punimeve, ndërtuesi duhet t'i dorëzojë blerësit një policë sigurimi me afat dhjetëvjeçar me përfitues blerësin/blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve, që mbulon dëmet e ndërtesës, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin kur, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda, që shfaqen pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë.

Sigurimi i detyrueshëm për dëmet shkaktuar palëve të treta, në rast aksidenti prej sistemeve dhe bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës



Ky sigurim mbulon përgjegjësinë ligjore të të siguruarit, ndaj dëmeve që u shkaktohen palëve të treta nga ngjarja e sigurimit, ndodhur gjatë periudhës së sigurimit në ambientet e subjektit tregtues të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, që përfshin:

- Humbje ose dëmtime trupore (përfshirë vdekjen, sëmundjen ose plagosjen) të/ose ndaj personave;
- Humbje ose dëmtime të pasurisë.



Kuadri rregullator lidhet me Ligjin nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”,

Ligji nr. 32/2016 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve/instalimeve nën presion”

si dhe VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

dhe Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

Sigurimi i përgjegjësisë ligjore për dëmet që mund t'i shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë të shoqërive të autorizuara për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre

Sigurimi i përgjegjësisë ligjore për dëmet që mund të shkaktohen për shkak të ushtrimit të veprimtarisë të shoqërive të autorizuara për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre rregullohen në bazë të VKM “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar me VKM nr.1047, datë 16.7.2008.

Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t'u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.


Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë deri në çastin e paraqitjes së dokumentit për sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet e në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin”.

Sigurimi i Jetës për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri

Sipas Ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" neni 32, përcaktohet se: "Punonjësi i shërbimit të MZSH-së përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.



Policat e Përgjegjesisë së Përgjithshme Civile



Përgjegjësi Civile është një produkt sigurimi që ndihmon në reputacionin e biznesit, pasi mbulon dëmtimet e ndryshme trupore dhe materiale që mund të i ndodhin klientëve brenda ambienteve të biznesit.

Objekti i sigurimit janë dëmtimet trupore ose materiale të palëve të treta kur këto ndodhen brenda ambientit të punës /biznesit.

Sigurimi i përgjegjesisë civile ndaj të tretëve mund të përdoret edhe nga persona fizike.

Kjo policë na lejon të mbrohemi nga të gjitha ato situata të cilat, për shkak të dëmeve të shkaktuara palëve të treta, ndikojnë në pasurinë e individit që sigurohet.

Pra kjo policë mbron pasurinë e të sigurvearit kur ai gjendet në kushtet e detyrimit për dëmshpërblim si pasojë e një dëmi të pavullnetshëm shkaktuar një personi të tretë.

Me anë të kësaj police mund të mbrohen dëmet e shkaktuara nga i sigurveuari ose nga familjarët e tij. Dëmi i shkaktuar mund të jetë pasuror ose jo pasuror.



4. KU MUND TË SIGUROHENI ?



Kontrata e sigurimit të Përgjegjësisë së Përgjithshme Civile mund të lidhet direkt me shoqërinë e sigurimit, ose përmes ndërmjetësve në sigurime, të licencuar/miratuar nga AMF dhe të regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve në Sigurime.

Në secilin rast, kontrata e sigurimit lidhet me vetë shoqërinë e sigurimit dhe jo me ndërmjetësit në sigurime. Nëse një agjent apo broker në sigurime kontakton me konsumatorët dhe propozon një takim për të prezantuar një produkt sigurimi, konsumatorët duhet të jenë të përgatitur për këtë takim dhe të mendojnë se çfarë kanë nevojë të sigurojnë. Përpara se agjenti apo brokeri të prezantojë produktin bëni verifikime mbi:

- Emrin, mbiemrin dhe adresën e ushtrimit të veprimtarisë;
- Licencën/Vërtetimin për të ofruar këto lloj shërbimesh dhe;
- Shoqërinë e sigurimit për të cilën punon.



Cilat janë shoqëritë e sigurimit të cilëve mund t'u drejtohesh?

Kontratat e sigurimit ofrohen nga shoqëritë e sigurimit, të cilët janë persona juridikë të licencuar dhe mbikëqyrur nga AMF për të ushtruar veprimtari sigurimi të Jetës dhe Jo-Jetës. Lista me shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, gjendet në faqen e internetit të AMF-së

https://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp.

Para nënshkrimit të një kontrate sigurimi gjithmonë verifikoni që emri i shoqërisë së sigurimit i përgjigjet saktësisht njërës prej atyre që janë të listuara në faqen e internetit të AMF-së.

Cilët janë ndërmjetësit në sigurime të cilëve mund t'ju drejtohesh?

Ndërmjetësit në sigurime, të cilëve mund t'ju drejtohesh, janë agjentët apo shoqëritë e agjentëve dhe brokerat apo shoqëritë e brokerimit. Veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari.

Veprimtaria e brokerimit në sigurime përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negociimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, duke identifikuar ofertën më të mirë të sigurimit në treg për konsumatorin, duke e paralajmëruar për mangësitë apo avantazhet e produktit, për t'ju mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të konsumatorit. Nëse është e nevojshme, brokeri propozon ndryshime në kontratën e sigurimit, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Në faqen zyrtare online www.amf.gov.al gjendet e publikuar listën e ndërmjetësve të licencuar/autorizuar për të kryer shërbime ndërmjetësimi.

Kur konsiderohet e lidhur kontrata e sigurimit?

Kontrata e sigurimit konsiderohet e lidhur dhe prodhon efektet e saj, kur është:

- Nënshkruar polica e sigurimit nga të dy palët dhe;
- Paguar primi apo kësti i parë i tij.

Kujdesuni të merrni një kopje origjinale të policës dhe verifikoni që dokumenti nuk përmban korrigjime.

Polica e sigurimit është dokumenti që vërteton që ju keni një sigurim të vlefshëm



Pagesa e primit të sigurimit

Pagesa e primit mund të kryhet në disa forma, në varësi të kontratës së sigurimit:

- Me këste;
- Për të gjithë periudhën.

Pagesa e primit mund të kryhet nëpërmjet sistemit bankar dhe/ose para në dorë.

Si dëshmi e pagesës së primit mund të jetë, dokumenti bankar i pagesës apo mandati i arkëtimit i lëshuar nga shoqëria e sigurimit me përshkrimin e pagesës së kryer.



5. DETYRIMI PËR INFORMIM

Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime detyrohen t'ju japin me shkrim, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin përkatës të sigurimit.

Ky informacion përmban:

- Të dhëna rreth shoqërisë së sigurimit, si: Emri dhe adresa e shoqërisë, e degës, apo ndërmjetësit, nëpërmjet të cilit po bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;
- Rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara;
- Afatet e fillimit dhe mbarimit të kontratës së sigurimit;
- Mënyrat e ndryshimit dhe përfundimit të kontratës;
- Metoda e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mos pagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë;
- Procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe struktura përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit apo shumës së sigurimit;
- Procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit, pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë;
- Të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.

Kuadri ligjor kërkon që informacioni i detajuar për kushtet e kontratës mund t'i jepet konsumatorit edhe nëpërmjet telefonit apo shërbimit të qendrës së komunikimit, por biseda telefonike duhet të regjistrohet.



Format e përmbushjes së detyrimit për informim

Çdo shoqëri sigurimi detyrohet të informojë të siguruarin nëpërmjet faqes zyrtare të Internetit dhe/ose me shkrim, lidhur me sigurimin e ofruar, mbulimin dhe çështje të tjera.

Informacioni duhet të jetë:

- I plotë
- I saktë
- I qartë
- Lehtësisht i aksesueshëm

Konsultoni faqet *online* të shoqërive të sigurimit të cilat ofrojnë sigurimin e detyrueshëm motorik apo pyesni punonjësin e shoqërisë ose ndërmjetësin për të marrë informacionin që Ju nevojitet.

Gjithashtu, shoqëria e sigurimit merr informacion nga ju për të përcaktuar masën dhe nivelin e rrezikut. Këtë informacion zakonisht shoqëria e mbledh nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve. Pyetjet në pyetësor janë formuluar në formatin "Po" dhe "Jo", me qëllim që të merret i gjithë informacioni i duhur, në mënyrë që policia e sigurimit të përshtatet me nevojën për sigurim të individit. Pyetësori është shumë i rëndësishëm, sepse dhe shoqëria e sigurimit merr të gjithë informacionin që i nevojitet nga ju.

Ju duhet të plotësoni pyetësorin personalisht dhe me kujdes: Në rast të informacionit të pasaktë ose jo të plotë, shoqëria e sigurimit, në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, mund të refuzojë apo zvogëlojë pagesën e dëmshpërblimit.



7. ANKIMIMI

Si bëhet kërkesa për dëmshpërblim ?

Në rast të vërtetimit të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit brenda afatit të parashikuar në kontratën e sigurimit, lind e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin. Për këtë arsye, për të përfituar shumën e dëmshpërblimit, duhet të paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm i përcaktuar në policën e sigurimit. Bëni kujdes që kërkesa për dëmshpërblim të paraqitet brenda afateve të rëna dakord në kontratën e sigurimit, në të kundërt shoqërisë së sigurimit i lind e drejta të mos paguajë dëmshpërblimin/shumën e sigurimit. Shoqëria e sigurimit nuk e paguan dëmshpërblimin, nëse kërkesa për dëmshpërblim është kryer pas afatit 2-vjeçar nga data e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Si mund të bëni një ankesë ?

Nëse keni pakënaqësi apo mendoni që shoqëria e sigurimit nuk i përmbahet kushteve të kontratës, ju mund të bëni një ankesë. Për të marrë më tepër informacion jeni të lutur të konsultoheni me materialin informues për ankesat, të lëshuara nga Autoriteti, i cili gjendet në www.amf.gov.al

8. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Kontratat e sigurimit rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (Kreu XXIII – Sigurimi), si **Ligji nr. 52**, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Rregullat sipas të cilave shoqëritë e sigurimit përmbushin detyrimin për informimin të të siguruarve apo personave të tjerë të interesuar përcaktohen nga **Ligji nr. 52**, datë 22.05.2014 dhe Rregullorja Nr. 36, datë 28 maj 2015 miratuar nga AMF.

